



Planuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Received/Delivered	26.05.2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHUK	2646/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.299/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2176/2021 të datës 22.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.419/2019 të datës 22.07.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga "Basri Canolli"-Kolevicë P/N, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 25.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.419/2019 e datës 22.07.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokollit 305 i datës 08.07.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke ia kompensuar ankuesit diferencën në pagë sipas akt emërimit të datës 28.12.2017, në mënyrë retroaktive për periudhën kohore prej datës 01.01.2018 deri me datë 31.04.2019.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën e punës Nëpunës për Informim në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, me datë 22.07.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit

3256/2019 të regjistruar me numër A.nr.419/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 305 të datës 08.07.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, përmes të cilit është refuzuar ankesa e datës 10.06.2019, si e pa bazuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 07.05.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës. Këshilli me datë 14.05.2021 ka pranua nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, përgjigjen në kërkesë me numër protokolli: 2404/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 22.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2176/2021 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 22.07.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3256/2019 të datës 22.07.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër: 305 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës të datës 08.07.2019; Kërkesën për kompensim të datës 31.05.2019; Kërkesën për ngritje të koeficientit të datës 10.04.2015; Listën e pagës për muajin maj të vitit 2019 të ankuesit; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.11.2015; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.12.2017; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.07.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë nëpërmjet e-maili të datës 07.05.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 14.05.2021; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.01.2014; Kërkesën për avancim dhe ngritje të koeficientit të datës 10.04.2015 me numër prot:3007; Listën e pagës për muajin prill të vitit 2019 të ankuesit; Formularin e të dhënave për listën e pagave të datës 01.11.2018; Formularin e të dhënave për listën e pagave të datës 01.05.2019; Aktgjykimit me numër A.nr.2176/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 22.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa A.nr.419/2019 e datës 22.07.2019, e parashtruar nga ankuesi **është e pjesërisht e bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se organi punëdhënës, respektivisht Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës me rastin e nxjerrjes se vendimit me numër: 305 të datës 08.07.2019 me të cilin e ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit të datës 10.06.2019 ka vepruar në kundërshtim me dispozita ligjore në fuqi, pasi që i ka mohuar të drejtën për kompensimin material në mënyrë retroaktiv për periudhën kohore prej datës 10.04.2015 deri me datë 01.04.2019 sipas akt emërimit me numër prot:348 të datës 21.10.2015.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vendosjes në mënyrë meritore ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht nenin 50 paragrafi 1 i cili përcakton se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 si dhe nenin 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.*

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.299/2021

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesi
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

